UDHËZIM
Nr. 8, datë, 12.4.2022

MBI INFORMACIONIN TEKNIK TË NEVOJSHËM PËR ELEMENTET E KONTROLLIT TEKNIK, METODAT E REKOMANDUARA TË KONTROLLIT DHE RREGULLAT QË LIDHEN ME FORMATIN E TË DHËNAVE DHE PROCEDURAT PËR ARRITJEN E INFORMACIONIT TEKNIK PËRKATËS TË MJETEVE RRUGORE DHE RIMORKIOVE TË TYRE[1]

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, paragrafi 4, nenit 79, të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, nenit 234 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 153, datë 7.4.2000, "Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, të Rregullores zbatuese të Komisionit Evropian 2019/621, të 17 prillit 2019, ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë,

UDHËZON:

Neni 1
Objekti

1. Ky udhëzim përcakton për kontrollin teknik të mjeteve rrugore dhe rimorkiove të tyre:

a) tërësinë e informacionit teknik mbi pajisjet e frenimit, të drejtimit, të dukshmërisë, ndriçuesit, pajisjet elektrike, boshtet, rrotat, gomat, amortizatorët, shasinë, aksesorët e lidhur në të, pajisjet e zhurmave dhe pajisjet e tjera të nevojshme që do të kontrollohen për mjetet rrugore dhe rimorkiot e tyre dhe mbi përdorimin e metodave të rekomanduara të kontrollit sipas legjislacionit në fuqi për kontrollin teknik të mjeteve rrugore dhe rimorkiove të tyre; dhe

b) rregullat e detajuara lidhur me formatin e të dhënave dhe procedurat për arritjen e informacionit teknik përkatës për mjetet motorike dhe rimorkiot e tyre.

Neni 2
Fusha e zbatimit

Ky udhëzim zbatohet për mjetet rrugore dhe rimorkiot e tyre që janë subjekt i kontrollit teknik sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 3
Përkufizime

Përkufizimet e mëposhtme zbatohen për qëllimin e këtij udhëzimi:

1. *"prodhues"* nënkupton çdo person fizik ose juridik, i cili është përgjegjës për të gjitha aspektet e miratimit të tipit të mjetit, sistemit, komponentit ose njësisë teknike të veçantë, ose miratimit individual të mjetit ose të pjesëve të këmbimit dhe pajisjeve, për të siguruar konformitetin e prodhimit dhe çështjeve të mbikëqyrjes së tregut që lidhen me mjetin, sistemin, pajisjen ose njësinë e veçantë teknike të prodhuar, pavarësisht në se personi/subjekti është direkt i përfshirë në të gjitha fazat e projektimit dhe ndërtimit të mjetit, sistemit, pajisjes ose njësisë teknike të veçantë;

2. *"përfaqësues i prodhuesit"* nënkupton çdo person fizik ose juridik me seli në Republikën e Shqipërisë, i cili është caktuar siç duhet të përfaqësojë prodhuesin përpara autoritetit të

[1] Ky udhëzim është përafruar plotësisht me rregulloren zbatuese të Komisionit Evropian 2019/621, të 17 prillit 2019, "Mbi informacionin teknik të nevojshëm për elementet e kontrollit teknik, mbi përdorimin e metodave të rekomanduara të kontrollit dhe vendosjen e rregullave të detajuara në lidhje me formatin e të dhënave dhe procedurat për aksesimin në informacionin përkatës teknik", numri CELEX 32019R0621, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, numër 108, datë 23.4.2019, faqe 5–28.

miratimit ose autoritetit të mbikëqyrjes së tregut dhe të veprojë në emër të prodhuesit për çështje të këtij udhëzimi;

3. *"makinë e lexueshme"* nënkupton përdorimin direkt të një kompjuteri;

4. *"informacioni i riparimit dhe mirëmbajtjes"* nënkupton të gjitha informacionet, që përfshijnë amendimet dhe shtesat e herëpashershme dhe nevojitet për diagnozën, shërbimet dhe inspektimin e mjetit, përgatitjen për kontroll teknik, riparim, riprogramimin apo riinstalimin e mjetit, ose nevojitet për suportin diagnostik në distancë të mjetit ose për përshtatjen në mjet të pjesëve të këmbimit apo pajisjeve dhe që u jepet nga prodhuesi partnerëve të tij të autorizuar, agjentëve tregtarë dhe riparuesve, ose përdoret nga prodhuesi për qëllim të mirëmbajtjes dhe të riparimit;

5. *"regjistrim"* nënkupton autorizimin administrativ për qarkullimin në rrugë të mjetit;

6. *"autoritet kompetent"* nënkupton një autoritet ose organ publik i ngarkuar nga ministri përgjegjës për transportin, përgjegjës për menaxhimin e sistemit të kontrollit teknik të mjeteve, duke përfshirë, aty ku është e përshtatshme, kryerjen e kontrolleve teknike;

7. *"qendra e kontrollit"* do të thotë një organ ose institucion publik ose privat i autorizuar nga ministri përgjegjës për transportin për të kryer kontrollet teknike.

Neni 4
Informacioni teknik i mjetit rrugor

Informacioni teknik i nevojshëm për kryerjen e kontrollit teknik është përcaktuar në shtojcën e këtij udhëzimi.

Neni 5
Procedurat për arritjen e informacionit teknik të mjetit rrugor

1. Informacioni teknik i mjetit, i përcaktuar në shtojcën 1 të këtij udhëzimi, të vihet në dispozicion të qendrave të kontrollit dhe autoritetit kompetent në një mënyrë jodiskriminuese, lehtësisht të arritshme, të pakufizuar, në kohë dhe vazhdimisht.

2. Informacioni teknik të vihet në dispozicion jo më vonë se 6 muaj pas regjistrimit të mjetit.

3. Bëjnë përjashtim rastet e parashikuara në pikat 6 dhe 8 të nenit 79, të Kodit Rrugor, për të cilat informacioni transmetohet sipas kërkesës dhe pa vonesa.

4. Prodhuesi të sigurojë ndryshimet dhe plotësimet pasuese të informacionit teknik, të përmendur në paragrafin 1, për qendrat e kontrollit dhe autoritetin kompetent, në të njëjtën kohë kur bëhen të disponueshme ndryshimet dhe plotësimet e informacioneve për riparimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve.

5. Informacioni teknik të vihet në dispozicion në gjuhën shqipe ose në ndonjë gjuhë tjetër të rënë dakord midis prodhuesit dhe autoritetit kompetent.

6. Prodhuesit caktojnë një pikë kontakti përgjegjëse për informacionin teknik të mjeteve. Detajet e kontaktit të kësaj pike duhet të vihen në dispozicion në faqen e internetit të prodhuesit. Pika e kontaktit mund të jetë edhe përfaqësuesi i prodhuesit.

7. Për të siguruar që qendrat e kontrollit të autorizuara, të arrijnë informacionin teknik të kërkuar, autoriteti kompetent të asistojë prodhuesin sipas nevojës.

Neni 6
Formati i të dhënave

1. Informacioni teknik të vihet në dispozicion nga prodhuesi bazuar në numrin e identifikimit të mjetit, në një burim të hapur dhe format të dhënash të strukturuar, për:

a) autoritetin kompetent, sipas kërkesës, si një koleksion të dosjeve të të dhënave të përdorshme nga "makina e lexueshme" jashtë linje (*offline*); dhe

b) qendrat e kontrollit teknik dhe autoritetin kompetent duke përdorur një zgjidhje në linjë (*online*). Kur përdoret një zgjidhje në linjë, informacioni teknik, i cili duhet të sigurohet nga

prodhuesi në të njëjtën kohë si pjesë e informacionit të riparimit dhe mirëmbajtjes në një faqe interneti, të vihet në dispozicion në të njëjtin format të dhënash. Informacione të tjera teknike të vihen në dispozicion në të njëjtin format të dhënash, që përdoret për informacione të ngjashme.

2. Prodhuesi mund të devijojë nga kërkesat e përmendura në pikën 1, në lidhje me mjetet që marrin miratimin e tipit individual, kombëtar apo të serisë së vogël siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për miratimin e tipit të mjeteve rrugore. Megjithatë, informacioni duhet të sigurohet në një mënyrë lehtësisht të arritshme dhe të qëndrueshme, që mund të përpunohet me përpjekje të arsyeshme.

3. Në rastin e mjeteve që marrin miratimin e tipit has pas hapi, të përziera ose me shumë faza, prodhuesi përgjegjës për fazën e veçantë të ndërtimit, është përgjegjës për komunikimin e informacionit teknik të mjetit te prodhuesi përfundimtar, në lidhje me një sistem të veçantë, pajisje ose njësi të veçantë teknike të asaj faze. Prodhuesi përfundimtar i mjetit është përgjegjës për dhënien e informacionit tek autoriteti kompetent dhe qendrat e kontrollit teknik.

4. Pika 3 nuk zbatohet për mjetet që marrin miratimin e tipit individual, kombëtar apo të serisë së vogël, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për miratimin e tipit të mjeteve rrugore.

Neni 7

Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

Belinda Balluku

SHTOJCA 1

1. TË PËRGJITHSHME

I. Për qëllimet e kësaj Shtojce, *"udhëzimet për përdorimin e ndërfaqes elektronike të mjetit"* nënkupton informacionin themelor diagnostikues dhe të testit të pajisjes, në veçanti:

I.1 Përshkrimi specifik për vendndodhjen dhe arritjen e ndërfaqësit elektronik të mjetit.

I.2 Informacion nëse sistemi i veçantë mbështet ndërveprimin diagnostikues (Po / Jo).

Nëse po:

I.2.1 Specifikimet e sistemit të veçantë për tipat dhe protokollet e rrjeteve të brendshme të komunikimit

I.2.2 Specifikimet e sistemit të veçantë për parametrat e komunikimit të sistemit/funksionit të inspektuar

I.2.3 Informacion i sistemit të veçantë rreth sistemit origjinal të instaluar.

II. Informacioni teknik që lidhet me mjetet e kategorisë L dhe mjetet jashtë fushës së veprimit të legjislacionit për kontrollin teknik të mjeteve rrugore është dhënë si udhëzues.

2. INFORMACION PËR KONTROLLIN TEKNIK

ELEMENTI	METODA	INFORMACIONI I NEVOJSHËM	Kategoria për të cilën informacioni është i nevojshëm				
			< 3,5t	>3, 5t	O	L	T
1. SISTEMI I FRENIMIT							
1.1 Gjendja mekanike dhe funksionimi							
1.1.1 Pedali i frenit / freni i dorës	Inspektim vizual i elementeve gjatë vënies në funksion të sistemit të frenimit. **Shënim**. *Mjetet me sistem frenimi të asistuar duhet të inspektohen me motor të fikur.*						
1.1.2 Gjendja e pedalit / Frenit të dorës dhe lëvizja për aktivizimin e frenave	Inspektim vizual i elementeve gjatë vënies në funksion të sistemit të frenimit. **Shënim.** *Mjetet me sistem frenimi të asistuar duhet të inspektohen me motor të fikur.*						
1.1.3 Rregullatori i ajrit të frenave	Inspektim vizual i elementeve në presion normal pune. Kontroll i kohës së nevojshme për vakumin ose presioni i ajrit që të arrijë vlerën e sigurt të punës, si dhe kontroll i funksionimit të pajisjes paralajmëruese, valvulës siguruese dhe valvulës për lëshimin e presionit.	Presioni / kufi max. - kufi min. në [bar] Shiko UN R13 5.1.4.5.2		X			
		Presioni statik i mbylljes të valvulës së mbrojtjes së qarkut-te shumëfishtë [bar] Shiko UN R13 5.1.4.5.2		X			X
1.1.4 Indikatori i presionit të ulët	Kontroll funksional						
1.1.5 Valvola e kontrollit të frenit të dorës	Inspektim vizual i elementeve gjatë funksionimit të sistemit të frenimit.						
1.1.6 Aktivizuesi i frenit parkimit, kontrolli i levës, mekanizmi bllokues i frenit parkimit, freni elektronik i parkimit	Inspektim vizual i elementeve gjatë funksionimit të sistemit të frenimit.	Përshkrim i përgjithshëm për frenën elektronike të parkimit	X	X			X
1.1.7 Valvolat e frenimit (valvolat e këmbës, rregullatorët, valvola rregulluese)	Inspektim vizual i elementeve gjatë funksionimit të sistemit të frenimit.						
1.1.8 Bashkuese për frenat e rimorkios (elektrike dhe pneumatike)	Shkëput dhe rilidh bashkimin e sistemit të frenimit ndërmjet mjetit tërheqës dhe rimorkios.						
1.1.9 Ena e presionit për	Inspektim vizual.						

ruajtjen e energjisë							
1.1.10 Përforcuesi i forcës së frenimit (servo), cilindri kryesor (sistemet hidraulike)	Inspektim vizual i elementeve gjatë funksionimit të sistemit të frenimit, nëse është e mundur.						
1.1.11 Tubat e ngurtë të frenave	Inspektim vizual i elementeve gjatë funksionimit të sistemit të frenimit, nëse është e mundur.						
1.1.12 Tubat elastikë të frenave	Inspektim vizual i elementeve gjatë funksionimit të sistemit të frenimit, nëse është e mundur.						
1.1.13 Tamburët	Inspektim vizual.	Metoda e vlerësimit të veshjes dhe kufirit të veshjes Shiko UN R13 5.2.1.11.2 dhe 5.2.2.8.2.	X	X	X	X	
1.1.14 Tamburet e frenave, disqet e frenave	Inspektim vizual.	Metoda e vlerësimit të veshjes dhe kufirit të veshjes Shiko UN R13 5.2.1.11.2 dhe 5.2.2.8.2.	X	X	X		
1.1.15 Kabllot e frenave, shufrat, levat, lidhjet	Inspektim vizual i elementeve gjatë funksionimit të sistemit të frenimit, nëse është e mundur.						
1.1.16 Cilindri i frenave	Inspektim vizual i elementeve gjatë funksionimit të sistemit të frenimit, nëse është e mundur.	Lloji i cilindrit të frenimit Shërbimi / Parkimi Maksimumi lëvizjes [mm] Gjatësia e levës [mm] Shiko UN R13 5.1.4.5.2		X	X		
1.1.17 Rregullatori i forcës së frenimit	Inspektim vizual i elementeve gjatë funksionimit të sistemit të frenimit, nëse është e mundur.	Presioni i hyrjes [bar]		X	X		
		Presioni i daljes për x% të ngarkesës maksimale të boshtit [bar] UN R 13 Shtojca 10 7.4 + Diagrami 5		X	X		
1.1.18 Kompensimi automatik dhe indikatori i konsumit të frenave	Inspektim vizual.	Maksimumi i lëvizjes [mm] Shiko UN R13 5.1.4.5.2		X	X		
		parimi i punës [automatikisht / manualisht i rregulluar]		X	X		
1.1.19 Sistemi i frenimit me ngadalësim(kur është i montuar ose kërkuar)	Inspektim vizual.						
1.1.20 Funksionimi automatik i frenave të rimorkios	Shkëput bashkimin e sistemit të frenimit ndërmjet mjetit tërheqës dhe rimorkios.						
1.1.21 Sistemi i plotë i frenimit	Inspektim vizual.						
1.1.22 Lidhjet për kontroll (kur janë të montuara ose të kërkuara)	Inspektim vizual.	Vendndodhja dhe identifikimi i lidhjeve testuese Shiko UN R 13 5.1.4.2		X	X		
		Vendndodhja dhe identifikimi i lidhjeve testuese					X

		Shiko 2015/68 shtojcën I. 2.1.8.1					
1.1.23 Sistemi i frenimit me inerci	Inspektim vizual dhe nga funksionimi						
1.2 Performanca dhe efikasiteti i shërbimit të frenimit							
1.2.1 Performanca	Gjatë një prove në një bankoprovë të frenave ose, nëse është e pamundur, gjatë një prove në rrugë, apliko frenat në mënyrë progresive deri në forcën maksimale.	Kërkesat specifike për testimin e mjetit në një bankoprovë frenash (mënyra e testimit)	X	X	X	X	X
1.2.2 Efikasiteti	Testimi me një bankoprovë frenimi ose, nëse nuk mund të përdoret për arsye teknike, me një test të rrugës duke përdorur një instrument regjistrimi ngadalësues për të përcaktuar raportin e frenimit që lidhet me masën maksimale të autorizuar ose, në rastin e gjysmërimorkiove, shumën e ngarkesave të boshtit të autorizuar. Mjetet ose rimorkiot me një masë maksimale të lejuar që tejkalon 3,5 ton duhet të inspektohen sipas standardeve të dhëna nga ISO 21069 ose metoda ekuivalente. Testet rrugore duhet të kryhen në kushte të thata në një rrugë të sheshtë dhe të drejtë.	Presioni i projektuar i sistemit për ngarkesë maksimale [bar] Shiko UN R13 5.1.4.5.2		X	X		
		Referenca e forcës frenimit [kN] për presionin e hyrjes [bar] boshti 1		X	X		
		Referenca e forcës frenimit [kN] për presionin e hyrjes [bar] boshti 2		X	X		
		Referenca e forcës frenimit [kN] për presionin e hyrjes [bar] boshti 3		X	X		
		Referenca e forcës frenimit [kN] në presionin e hyrjes [bar] boshti 4 Shiko UN R13 5.1.4.6.2		X	X		
		Llogaritja e presionit për secilin bosht		X	X		
1.3 Performanca dytësore (emergjencës) e frenimit dhe efikasiteti (nëse plotësohet nga sistemi i veçantë)							
1.3.1 Performanca	Nëse sistemi i frenimit sekondar është i ndarë nga sistemi i frenimit të shërbimit, përdorni metodën e specifikuar në 1.2.1.	Përshkrimi i përgjithshëm i sistemit duke përfshirë qarqet (përcaktimi i qartë i frenave sekondare)	X	X			X
1.3.2 Efikasiteti	Nëse sistemi i frenimit sekondar është i ndarë nga sistemi i frenimit të shërbimit, përdorni metodën e specifikuar në 1.2.2.						
1.4 Performanca dhe efikasiteti i frenave të parkimit							
1.4.1 Performanca	Apliko frenat gjatë një kontrolli në një bankoprovë të frenave.	Përshkrimi i përgjithshëm i sistemit duke përfshirë procedurën e rekomanduar të testimit nëse testimi dinamik (në testuesin e frenave ose testin e rrugës) nuk është i mundur	X	X	X		
1.4.2 Efikasiteti	Kontrollo në një bankoprovë të frenimit. Nëse nuk është e mundur, atëherë me anë të një prove në rrugë duke përdorur ose një instrument të regjistrimit ose të ngadalësimit ose me mjetin në një pjerrësi të gradientit të njohur.						

1.5 Performanca e qëndrueshmërisë së sistemit të frenimit	Inspektimi vizual dhe, aty ku është e mundur, testoni nëse sistemi funksionon.	Përshkrim i përgjithshëm		X			
1.6 Sistemi i frenimit antibllokues (ABS)	Inspektimi vizual dhe inspektimi i pajisjes paralajmëruese dhe/ ose përdorimi i ndërfaqes elektronike të mjetit.	Udhëzime për përdorimin e ndërfaqësit elektronik të automjetit	X	X	X	X	X
1.7. Sistemi elektronik i frenimit (EBS)	Inspektimi vizual dhe inspektimi i pajisjes paralajmëruese dhe/ ose përdorimi i ndërfaqes elektronike të mjetit.	Udhëzime për përdorimin e ndërfaqësit elektronik të automjetit	X	X	X		X
1.8 Lëngu i frenave	Inspektimi vizual						
2. SISTEMI I DREJTIMIT							
2.1 Gjendja mekanike							
2.1.1 Gjendja e mekanizmit të drejtimit	Me mjetin mbi një gropë ose në një urë ngritëse dhe me rrotat të shkëputura nga toka ose mbi pllaka rrotulluese, rrotullo timonin nga një ekstremitet në tjetrin. Inspektim vizual i funksionimit të mekanizmit të drejtimit.						
2.1.2 Fiksimi i kutisë së mekanizmit të drejtimit	Me mjetin mbi një gropë ose në një urë ngritëse dhe me peshën e rrotave në tokë, rrotullo timonin në sens orar dhe antiorar ose duke përdorur një instrument të posaçëm për të zbuluar xhokon e rrotave. Inspektim vizual i fiksimit të kutisë së mekanizmit të drejtimit në shasi.						
2.1.3 Gjendja e lidhjeve në sistemin e drejtimit	Me mjetin mbi një gropë ose në një urë ngritëse dhe me rrotat në tokë, lëviz timonin në sens orar dhe antiorar ose duke përdorur një instrument të posaçëm për të zbuluar xhokon e rrotave. Inspektim vizual i komponentëve të sistemit të drejtimit në lidhje me konsumimin, dëmtimet dhe sigurinë.						
2.1.4 Funksionimi i lidhjeve në sistemin e drejtimit	Me mjetin mbi një gropë ose në një urë ngritëse dhe me rrotat në tokë, lëviz timonin në sens orar dhe antiorar ose duke përdorur një instrument të posaçëm për të zbuluar xhokon e rrotave. Inspektim vizual i komponentëve të sistemit të drejtimit në lidhje me konsumimin, dëmtimet dhe sigurinë.						
2.1.5 Sistemi ndihmës i	Kontrollo sistemin e drejtimit për rrjedhje dhe						

drejtimit	nivelin e lëngut hidraulik në depozitë (nëse është i dukshëm). Me rrotat në tokë dhe me motorin e ndezur, kontrollo nëse servo përforcuesi funksionon.						
2.2 Timoni/boshti timonit							
2.2.1 Gjendja e timonit / gjendja e dorezës	Me mjetin mbi një gropë ose në një urë ngritëse dhe peshën e mjetit në tokë, shtyje dhe tërhiqe timonin në drejtim të boshtit, shtyje timonin në drejtime të ndryshme në kënd të drejtë me boshtin. Inspektim vizual i xhokove dhe gjendjes së lidhjeve fleksible ose nyjave universale.						
2.2.2 Boshti timonit / krahët nofulla dhe amortizatori drejtues	Me mjetin mbi një gropë ose në një urë ngritëse dhe peshën e mjetit në tokë, shtyje dhe tërhiqe timonin në drejtim të boshtit, shtyje timonin në drejtime të ndryshme në kënd të drejtë me boshtin. Inspektim vizual i xhokove dhe gjendjes së lidhjeve fleksible ose nyjave universale.	Timoni i pajisur me amortizator (PO/JO)				X	
2.3 Xhoko e timonit	Me mjetin mbi një grope ose në një urë ngritëse, me masën e mjetit mbi rrota, me motorin, mundësisht të ndezur për mjetet me servo përforcues dhe me rrotat në pozicionin drejt, kthe lehtësisht timonin në sens orar dhe antiorar, sa më tepër të jetë e mundur pa lëvizur rrotat. Inspektim vizual i lëvizjes boshe.						
2.4 Orientimi i rrotave (X) [2]	Kontrollo orientimin e rrotave drejtuese me pajisjet e duhura.						
2.5 Kurora kthyese e boshtit drejtues të rimorkiot	Inspektim vizual ose duke përdorur një instrument të posaçëm për të zbuluar xhokon e rrotave.						
2.6 Sistemi i drejtimit elektronik (EPS)	Inspektim vizual dhe kontroll i përputhjes ndërmjet këndit të timonit dhe këndit të rrotave kur fiket dhe ndizet motori, dhe/ose duke përdorur ndërfaqen elektronike të automjetit.	Udhëzime për përdorimin e ndërfaqësit elektronik të automjetit					
3. SHIKUESHMËRIA							
3.1 Fusha e shikimit	Inspektim vizual nga pozicioni i drejtuesit të						

	automjetit						
3.2 Gjendja e xhamave.	Inspektim vizual						
3.3 Pasqyrat ose pajisjet retrovizore	Inspektim vizual						
3.4 Fshirëset e xhamave	Inspektim vizual dhe gjatë funksionimit						
3.5 Larëset e xhamave	Inspektim vizual dhe gjatë funksionimit						
3.6 Sistemi kundër avullimit (X) [2]	Inspektim vizual dhe gjatë funksionimit						
4. DRITAT, REFLEKTORËT DHE PAJISJET ELEKTRIKE							
4.1 Dritat kryesore							
4.1.1 Gjendja dhe funksionimi	Inspektim vizual dhe gjatë funksionimit.	Kategoria e burimit të dritës [...,...]	X	X		X	X
4.1.2 Orientimi	Përcakto orientimin horizontal të çdo drite të shkurtër duke përdorur një pajisje për orientimin e dritave ose duke përdorur ndërfaqen elektronike të automjetit.	Shtrirja e rrezes së dritës [për qind] për prirjen dhe drejtimin vertikal	X	X		X	
		Udhëzime për përdorimin e ndërfaqësit elektronik të automjetit	X	X		X	
		Për përcaktimin e orientimit horizontal duke përdorur informacionin e ndërfaqësit elektronik të automjetit mbi aktivizimin e lëvizjes së rrezes së fenerit për të lejuar vlerësimin e shtrirjes	X	X		X	
4.1.3 Çelësi	Inspektim vizual dhe gjatë funksionimit ose duke përdorur ndërfaqen elektronike të automjetit	Udhëzime për përdorimin e ndërfaqësit elektronik të automjetit	X	X		X	
4.1.4 Përputhshmëria me kërkesën[1]	Inspektim vizual dhe gjatë funksionimit.						
4.1.5 Sistemi për rregullimin e lartësisë së dritave (kur është i detyrueshëm)	Inspektim vizual dhe gjatë funksionimit, nëse është e mundur, ose duke përdorur ndërfaqen elektronike të automjetit.	Mënyra e përdorimit [manual/automatik)	X	X		X	
		Udhëzime për përdorimin e ndërfaqësit elektronik të automjetit	X	X		X	
4.1.6 Pajisja për pastrimin e dritave kryesore (kur është e detyrueshme)	Inspektim vizual dhe gjate funksionimit, nëse është e mundur.	Pajisja e detyrueshme [PO/JO]	X	X			
4.2 Dritat të përparme dhe të pasme të pozicionit, dritat anësore, dritat gabarite dhe dritat e ditës							
4.2.1 Gjendja dhe funksionimi	Inspektim vizual dhe gjate funksionimit	Prania e dritave të ditës [Po/Jo]	X	X		X	
4.2.2 Çelësi	Inspektim vizual dhe gjate funksionimit.						
4.2.3. Përputhshmëria me kërkesën [1]	Inspektim vizual dhe gjate funksionimit.						
4.3 Dritat e frenave							
4.3.1 Gjendja dhe	Inspektim vizual dhe gjate funksionimit.						

funksionimi							
4.3.2 Çelësi	Inspektim vizual dhe gjatë funksionimit ose duke përdorur ndërfaqen elektronike të automjetit.	Pajisja e sinjalit të ndalimit emergjent , [PO/JO]	X	X	X		
		Udhëzime për përdorimin e ndërfaqësit elektronik të automjetit	X	X	X		
4.3.3 Përputhshmëria me kërkesat[1]	Inspektim vizual dhe gjatë funksionimit.						
4.4 Treguesi i drejtimit dhe dritat sinjalizuese të rrezikut							
4.4.1 Gjendja dhe funksionimi	Inspektim vizual dhe gjatë funksionimit.						
4.4.2 Çelësi	Inspektim vizual dhe gjatë funksionimit.						
4.4.3 Përputhshmëria me kërkesat [1].	Inspektim vizual dhe gjatë funksionimit						
4.4.4 Frekuenca e fleshimit	Inspektim vizual dhe gjatë funksionimit						
4.5 Dritat e përparme dhe të pasme të mjegullës							
4.5.1 Gjendja dhe funksionimi	Inspektim vizual dhe gjatë funksionimit.						
4.5.2 Orientimi (X) [2]	Gjatë funksionimit ose duke përdorur një pajisje për orientimin e dritave.						
4.5.3 Çelësi	Inspektim vizual dhe gjatë funksionimit.						
4.5.4 Përputhshmëria me kërkesat[1]	Inspektim vizual dhe gjatë funksionimit						
4.6 Dritat për ngjarje mbrapa							
4.6.1 Gjendja dhe funksionimi	Inspektim vizual dhe gjatë funksionimit.						
4.6.2 Përputhshmëria me kërkesën [1]	Inspektim vizual dhe gjatë funksionimit						
4.6.3 Çelësi	Inspektim vizual dhe gjatë funksionimit						
4.7 Drita për ndriçimin e targës së pasme							
4.7.1 Gjendja dhe funksionimi	Inspektim vizual dhe gjatë funksionimit						
4.7.2 Përputhshmëria me kërkesat [1]	Inspektim vizual dhe gjatë funksionimit						
4.8 Reflektorët, shenjat reflektuese dhe shiritat e pasme shënjues							
4.8.1 Gjendja	Inspektim vizual						
4.8.2 Përputhshmëria me kërkesat	Inspektimi vizual						
4.9 Dritat identifikuese të detyrueshme për pajisjet ndriçuese							

4.9.1 Gjendja dhe funksionimi	Inspektim vizual dhe gjatë funksionimit.						
4.9.2 Përputhshmëria me kërkesat [1]							
4.10 Lidhjet elektrike ndërmjet mjetit tërheqës dhe rimorkios apo gjysmërimorkios	Inspektim vizual: nëse është e mundur kontrollo lidhjet elektrike						
4.11. Kabllot elektrike	Inspektim vizual me mjetin mbi një gropë ose në një urë ngritëse, përfshirë hapësirën e kompartimentit të motorit (nëse është e zbatueshme)	Identifikimi i telave / kabllove (p.sh. ngjyra, mbrojtja, seksion kryq, madhësia), monitorimi i izolimit (tension i lartë)	X	X		X	
		Vendndodhja e ndonjë kabllo tensioni të lartë	X	X		X	
4.12. Dritat dhe reflektorët jo të detyrueshme (X)2	Inspektim vizual dhe gjatë funksionimit.						
4.13. Bateria (Bateritë)	Inspektim vizual	Vendndodhja e baterisë/ve	X	X		X	X
		Numri i baterive	X	X		X	X
		Vendosje e veçantë për bateritë e voltazhit të lartë	X	X		X	
		Informacione të veçanta të mjetit (VIN) mbi fikjen/ndezjen e baterisë [PO/JO]	X	X		X	
		Informacione të veçanta të mjetit (VIN) mbi siguresën e baterisë [PO/JO]	X	X		X	
		Informacione të veçanta të mjetit (VIN) mbi ventilimin e baterisë [PO/JO]	X	X		X	
		Informacione të veçanta të mjetit (VIN) mbi parimet funksionimit	X	X		X	
5. BOSHTET, RROTAT, GOMAT DHE SUSPENSIONI							
5.1 Boshtet							
5.1.1 Boshtet	Inspektim vizual me mjetin mbi një gropë ose në një urë ngritëse. Mund të përdoren zbulues të xhokove të rrotave dhe janë të rekomanduar për mjete që kanë një masë që tejkalon 3,5 tonë.	Përshkrim i përgjithshëm, numri i boshteve	X	X	X	X	X
5.1.2 Gjysmëboshtet	Inspektim vizual me mjetin mbi një gropë ose në një urë ngritëse. Mund të përdoren zbulues të xhokove të rrotave dhe janë të rekomanduar për automjetet me një masë maksimale që tejkalon 3,5 tonë. Ushtro një forcë vertikale ose laterale në secilën rrotë dhe						

	vëre lëvizjen bosh ndërmjet qendrës së rrotës dhe gjysmëboshtit.						
5.1.3 Kushinetat	Inspektim vizual me mjetin mbi një gropë ose në një urë ngritëse. Mund të përdoren zbulues të xhokove të rrotave dhe janë të rekomanduar për automjetet me një masë maksimale që tejkalon 3,5 tonë. Lëviz rrotën ose ushtro një forcë laterale dhe vëre kthimin e rrotave në raport me gjysmëboshtin.						
5.2 Rrotat dhe gomat							
5.2.1 Disku i rrotës	Inspektim vizual.						
5.2.2 Rrotat	Inspektim vizual i të dy anëve të çdo rrote me mjetin mbi një gropë ose në një urë ngritëse.	Madhësia e rrotës/dimensionet/mënjanimi	X	X	X	X	X
5.2.3 Gomat	Inspektim vizual i të gjithë gomës duke e rrotulluar rrotën e shkëputur nga toka me mjetin mbi një gropë ose në një urë ngritëse, ose duke e lëvizur mjetin përpara dhe mbrapa mbi një gropë.	Përmasa gomës, Kapaciteti ngarkesës, Kategoria e shpejtësisë	X X X	X X X	X X X	X X X	X X X
		Sistemi i monitorimit të presionit të gomës [PO/JO] direkt/indirekt	X	X	X	X	X
5.3. Sistemi i suspensionit							
5.3.1. Spiralet dhe stabilizuesi	Inspektim vizual me automjetin mbi një gropë ose në një urë ngritëse. Mund të përdoren zbulues të xhokove të rrotave dhe janë të rekomanduar për automjetet me një masë maksimale që tejkalon 3,5 tonë.						
5.3.2 Amortizatorët	Inspektim vizual me mjetin mbi një gropë ose në një urë ngritëse ose duke përdorur pajisje të veçanta, nëse është e mundur.						
5.3.2.1 Kontrolli i efikasitetit të amortizimit (X) [2]	Përdor pajisje të veçanta dhe krahaso anën e djathtë dhe anën e majtë.						
5.3.3 Boshti kardanik, shinat, krahët tërthor këndor dhe krahët tërthor	Inspektim vizual me mjetin mbi një gropë ose në një urë ngritëse. Zbulues të xhokove të rrotës mund të përdoren dhe janë të rekomanduar për mjetet me një masë maksimale që tejkalon 3,5 tonë.						
5.3.4 Nyjat e suspensionit	Inspektim vizual me mjetin mbi një gropë ose në një urë ngritëse. Mund të përdoren zbulues						

	të xhokove të rrotave dhe janë të rekomanduar për mjetet me një masë maksimale që tejkalon 3,5 tonë.						
5.3.5 Suspensioni pneumatik	Inspektim vizual						
6. SHASIA DHE ELEMENTET E FIKSUAR NË SHASI							
6.1 Shasia ose korniza dhe elementet e fiksuar në shasi							
6.1.1 Gjendja e përgjithshme	Inspektim vizual me mjetin mbi një gropë ose në një urë ngritëse.						
6.1.2 Tubat e shkarkimit dhe silenciatorët	Inspektim vizual me mjetin mbi një gropë ose në një urë ngritëse.						
6.1.3 Serbatori dhe tubat e karburantit (përfshirë ato për ngrohjen e karburantit)	Inspektim vizual me mjetin mbi një gropë ose në një urë ngritëse, përdorim i pajisjeve zbuluese të rrjedhjeve në rastin e sistemeve LPG / CNG / LNG.	Përshkrim i përgjithshëm dhe vendndodhja duke përfshirë shtresën mbrojtëse	X	X		X	X
6.1.4 Mbrojtësit, pajisjet për mbrojtje anësore dhe mbrojtje nga ana e pasme.	Inspektim vizual	Mbrojtëset anësore të lira dhe ose të prapme (PO/JO)		X	X		
6.1.5 Bartësi i rrotës rezervë (nëse është i montuar)	Inspektim vizual						
6.1.6 Pajisja mekanike për lidhje dhe tërheqje	Inspektim vizual i konsumimit dhe funksionimit korrekt duke i kushtuar vëmendje të veçantë çdo pajisjeje sigurie të montuar dhe / ose duke përdorur pajisje matëse.						
6.1.7. Transmisioni.	Inspektim vizual						
6.1.8. Mbajtësit e motorit	Inspektim vizual jo domosdoshmërisht mbi gropë ose në urë ngritëse						
6.1.9 Performanca e motorit (X) [2]	Inspektim vizual dhe/ose duke përdorur ndërfaqen elektronike.	Njësia e kontrollit të motorit konfigurimi i vlefshëm	X	X		X	X
		Udhëzime për përdorimin e ndërfaqësit elektronik të automjetit	X	X		X	X
		Udhëzime se si të lexoni identifikimin e kalibrimit	X	X		X	X
		Numrin e identifikimit të softuerit duke përfshirë sondat e kontrollit ose të dhëna të ngjashme të vlerësimit të integritetit.	X	X		X	X
6.2 Kabina dhe karroceria							
6.2.1 Gjendja	Inspektim vizual.						
6.2.2 Montimi	Inspektim vizual mbi një gropë ose në një urë ngritëse						

6.2.3 Dyert dhe mbyllësit e dyerve	Inspektim vizual						
6.2.4 Dyshemeja	Inspektim vizual mbi një gropë ose në një urë ngritëse						
6.2.5. Ndenjësja e drejtuesit të mjetit	Inspektim vizual						
6.2.6. Ndenjëset e tjera	Inspektim vizual	Numri maksimal i ndenjëseve në total (pa përfshirë ndenjësen e shoferit)	X	X			
		Numri i ndenjëseve me shpinë nga drejtimi i lëvizjes	X	X			
6.2.7. Pajisjet e kontrollit në drejtim	Inspektim vizual dhe gjatë funksionimit.						
6.2.8. Shkallët e kabinës	Inspektim vizual						
6.2.9. Pajisjet dhe aksesorët e tjerë të brendshëm dhe të jashtëm	Inspektim vizual						
6.2.10 Baltëpritësit, pajisjet kundër spërkatjes	Inspektim vizual						
6.2.11 Bazamenti	Inspektim vizual						
6.2.12 Dorezat dhe mbështetësit e këmbëve	Inspektim vizual						
7. PAJISJET E TJERA							
7.1 Rripat e sigurisë / mbërthyeset dhe sistemet e fiksimit (për sa i përket kategorisë L: L6/L7)							
7.1.1 Siguria e montimit të rripave të sigurisë / mbërthyeseve	Inspektim vizual.	Numri dhe vendi i pikave të ankorimit të rripave të sigurisë	X	X		X	X
7.1.2 Gjendja e rripave të sigurisë / mbërthyeseve	Inspektim vizual dhe gjatë funksionimit	Kategoria e rripave të sigurisë për çdo pozicion uljeje	X	X		X	X
7.1.3. Pajisja për kufizimin e ngarkesës së rripit të sigurimit	Inspektim vizual dhe / ose duke përdorur ndërfaqen elektronike	Udhëzime për përdorimin e ndërfaqësit elektronik të automjetit	X	X		X	
7.1.4 Parashtrënguesit e rripit të sigurimit	Inspektim vizual dhe/ose duke përdorur ndërfaqen elektronike	Udhëzime për përdorimin e ndërfaqësit elektronik të automjetit	X	X		X	
7.1.5 Jastëkët e ajrit (airbag)	Inspektim vizual dhe/ose duke përdorur ndërfaqen elektronike	Numri i jastëkëve të ajrit dhe vendndodhja	X	X		X	
		Udhëzime për përdorimin e ndërfaqësit elektronik të automjetit	X	X		X	
7.1.6 Sistemi SRS	Inspektim vizual i indikatorit të keqfunksionimit, dhe/ose duke përdorur ndërfaqen elektronike	Udhëzime për përdorimin e ndërfaqësit elektronik të automjetit	X	X		X	

7.2 Aparati për shuarje të zjarrit (X)[2]	Inspektim vizual						
7.3 Brava e derës dhe pajisja kundër vjedhjes	Inspektim vizual dhe gjatë funksionimit						
7.4 Trekëndëshi i sigurisë (nëse kërkohet) (X) [2]	Inspektim vizual						
7.5 Kutia e ndihmës së parë (nëse kërkohet) (X) [2]	Inspektim vizual						
7.6 Pykat e rrotave (nëse kërkohen) (X)[2]	Inspektim vizual						
7.7 Boria	Inspektim vizual dhe gjatë funksionimit						
7.8 Shpejtësimatësi	Inspektim vizual ose gjatë funksionimit në testet në rrugë ose me mjete elektronike	Udhëzime për përdorimin e ndërfaqësit elektronik të automjetit		X			
7.9 Tahografi (nëse është i instaluar / nëse kërkohet)	Inspektim vizual	Vendndodhja e sensorëve		X			
		Vendndodhja e vulave		X			X
7.10 Pajisja për kufizimin e shpejtësisë (nëse është e instaluar/ nëse kërkohet)	Inspektim vizual dhe gjatë funksionimit nëse pajisjet e duhura janë në dispozicion.						
7.11 Odometri (nëse është i disponueshëm) (X) [2]	Inspektim vizual dhe/ose duke përdorur ndërfaqen elektronike.	Udhëzime për përdorimin e ndërfaqësit elektronik të automjetit	X	X		X	
7.12. Kontrolli Elektronik i Stabilitetit (ESC) (nëse është i instaluar / nëse kërkohet)	Inspektim vizual dhe/ose duke përdorur ndërfaqen elektronike.	Udhëzime për përdorimin e ndërfaqësit elektronik të automjetit	X	X			
8. NDIKIMI NË MJEDIS							
8.1. Zhurma							
8.1.1. Sistemi për reduktimin e zhurmës	Vlerësim subjektiv (vetëm nëse inspektuesi e konsideron nivelin e zhurmave brenda kufijve, dhe në këtë rast mund të kryhet një matje e nivelit të zhurmave të nxjerra nga mjeti i ndaluar në vend duke përdorur një matës të nivelit të zhurmave)	Nivelet e zhurmës së mjetit i palëvizur [dB(A) në 1/min].	X	X		X	X
8.2 Emetimi i gazrave të shkarkimit							
8.2.1 Emetimi i gazrave të shkarkimit në motorët me ndezje të komanduar							
8.2.1.1 Pajisja për kontrollin e emetimit të gazrave të shkarkimit	Inspektim vizual	Përshkrimi i përgjithshëm i sistemit të kontrollit të shkarkimit. Instalim i filtrit të grimcave [PO/JO]	X	X			
8.2.1.2 Emetimet e gazrave	- Për mjetet deri në kategoritë e emetimit euro 5 dhe euro V ([1]):	Niveli i emetimit të gazeve nëse janë të dhëna nga prodhuesi	X	X		X	
		Informacion specifik i automjetit (VIN) ose Kodi i Motorit	X	X		X	

	matje duke përdorur një analizues të gazrave të shkarkimit në përputhje me kërkesën [1] ose duke lexuar sistemin për vetëdiagnostikimin në automjet (OBD). Matja e emetimit në tubat e shkarkimit duhet përdorur si metodë standarde për vlerësimin e emetimit të gazrave të shkarkimit. Mbi bazën e një vlerësimi të ekuivalencës, dhe duke pasur parasysh legjislacionin përkatës për homologimin e automjetit, mund të autorizohet përdorimi i OBD në përputhje me rekomandimet e prodhuesit dhe kritere të tjera. - Për mjetet në kategoritë e emetimit euro 6 dhe euro VI ([2]): matje duke përdorur një analizues të gazrave të shkarkimit në përputhje me kërkesën [1] ose duke lexuar sistemin për vetëdiagnostikimin në automjet (OBD) në përputhje me rekomandimet e prodhuesit dhe kritere të tjera [1]. Matjet jo të aplikueshme për motorët dykohësh.	Për testimin e tubave të pasmë të shkarkimit	Kërkesat e parakushtëzimit të motorit si min.temperaturës së vajit / temperaturës së ujit. [°C] dhe procedurat për të sjellë motorin në mënyrën e tipit II të testimit	X	X		X	
			Rezultatet e testit të emetimeve Tipi II	X	X		X	
			Motori në gjendje boshe CO [%]	X	X		X	
			Në gjendje boshe të lartë CO [%]	X	X		X	
			Lambda []	X	X		X	
		Për përdorimin OBD:	Protokolli i Lidhjes dhe Komunikimit (Standard, voltazhi i furnizimit me energji, vendndodhja)	X	X			
			Lista e DTC-ve (klas A, B1 dhe B2 aktualisht vetëm për HDV)	X	X			
8.2.2 Emetimi i gazrave të shkarkimit në motorët me ndezje të komprimuar								
8.2.2.1 Pajisja për kontrollin e emetimit të gazrave të shkarkimit	Inspektim vizual	Përshkrim i përgjithshëm mbi sistemin e emetimit. Si Sistemi DeNOx [PO/JO] Instalim i filtrit të grimcave [PO/JO]		X	X			
		Vendndodhja EGR		X	X			
		(Automjeti (VIN)/) informacion specifik për llojin e motorit		X	X			
8.2.2.2 Opaciteti Mjetet e regjistruara ose të vëna në shërbim përpara datës 1 janar 1980 janë të përjashtuara nga kjo kërkesë.	- Për mjetet deri në kategoritë e emetimit euro 5 dhe euro V (3): Opaciteti i gazrave të shkarkimit duhet të matet gjatë përshpejtimit të lirë (punës së lirë) (nga regjimi minimal i punës së motorit në regjim maksimal) me levën e marshit në pozicion neutral dhe friksionin e shkelur ose duke lexuar sistemin për vetëdiagnostikimin në automjet (OBD). Matja e emetimit në tubat e shkarkimit duhet përdorur si metodë standarde për vlerësimin e emetimit të gazrave të shkarkimit. Mbi bazën e një vlerësimi të	Informacion specifik i tipit të motorit të mjetit (VIN)		X	X		X	
		Për testimin e tubave të pasme të shkarkimit	Kërkesat e parakushtëzimit të motorit si min. Temp./temp. Ujit [°C] dhe procedurat për të sjellë motorin në tipin II të mënyrës testimit.	X	X		X	
			Vlera-k e regjistruar në tabelën e prodhuesit në mjet (rezultati i testit të	X	X		X	

	ekuivalencës, mund të autorizohet përdorimi i OBD në përputhje me rekomandimet e prodhuesit dhe kritere të tjera. - Për mjetet në kategoritë e emetimit euro 6 dhe euro VI (4): Opaciteti i gazrave të shkarkimit duhet të matet gjatë përshpejtimit të lirë (punës së lirë) (nga regjimi minimal i punës së motorit në regjim maksimal) me levën e marshit në pozicion neutral dhe friksionin e shkelur ose duke lexuar sistemin për vetëdiagnostikimin në automjet (OBD) në përputhje me rekomandimet e prodhuesit dhe kriteret e tjera 1. Parapërgatitja e mjetit: 1. Mjetet mund të kontrollohen pa parapërgatitje, megjithëse për arsye sigurie, duhet të kontrolloni nëse motori është i ngrohtë dhe në gjendje të kënaqshme mekanike. 2. Kërkesat për parapërgatitje: i. Motori duhet të jetë plotësisht i ngrohur, për shembull temperatura e vajit të motorit, e matur nëpërmjet një sonde futur në shufrën për matjen e nivelit të vajit, duhet të jetë të paktën 80°C, ose temperatura e bllokut të motorit, matur nëpërmjet nivelit të rrezeve infra të kuqe, duhet të jetë me një temperature të paktën ekuivalente. Nëse, për shkak të konstruksionit të automjetit, kjo matje është jo praktike, temperatura normale e punës së motorit mund të arrihet në mënyrë tjetër, p.sh. duke aktivizuar ventilatorin për ftohjen e motorit. ii. Sistemi i shkarkimit të gazrave duhet të pastrohet me të paktën tre cikle përshpejtimi të lirë ose me një metodë ekuivalente. Procedura e kontrollit: 1. Motori dhe turbokompresorët eventualë, duhet të jenë në minimum përpara fillimit të		shkarkimit të tipit II)					
			Ndërprerja e shpejtësisë Motorit në testet e Tipit	X	X		X	
			Kufiri i shpejtësisë së motorit për përshpejtimin pa ngarkesë [Y / N]	X	X		X	
			Përshkrimi për çaktivizimin e kufirit të shpejtësisë së motorit për të kryer testin e përshpejtimit të lirë;	X	X		X	
		Për përdorimin e OBD	DTC e lejuar në skedën OBD (kodet për grupin NOx 3000 për LDV)	X	X		X	
			Protokolli i lidhjes dhe komunikimit (standardi, voltazhi i furnizimit me energji, vendndodhja)	X	X		X	
			Lista e DTCve (klasi A, B1 e B2 aktualisht vetëm për HDV)	X	X		X	

	çdo cikli të përshpejtimit të lirë. Për mjetet e mëdha me motor diesel, kjo do të thotë se duhet pritur të paktën 10 sekonda pas lëshimit të pedalit të gazit. 2. Për të filluar çdo cikël përshpejtimi të lirë, pedali i gazit duhet të shtypet plotësisht deri në fund shpejt dhe në mënyrë të vazhdueshme (në më pak se një sekondë), por jo dhunshëm në mënyrë që pompa e injektimit të arrijë shpërndarjen maksimale të karburantit në motor. 3. Gjatë çdo cikli të përshpejtimit të lirë, motori duhet të arrije shpejtësinë në të cilën fillon ndërprerja e furnizimit me karburant, ose për automjetet me furnizues automatik, shpejtësinë e përcaktuar nga prodhuesi, ose, nëse kjo e dhëne nuk është e disponueshme, atëherë dy të tretat e shpejtësisë në të cilën fillon ndërprerja e furnizimit me karburant, para se pedali i gazit të lëshohet. Kjo mund të kontrollohet, për shembull, duke monitoruar shpejtësinë në motor ose duke lejuar një interval të mjaftueshëm ndërmjet shtypjes fillestare të pedalit të gazit dhe lëshimit të tij, i cili në rastin e mjeteve të kategorive M2, M3, N2 dhe N3, duhet të jetë të paktë dy sekonda. 4. Kontrolli do të konsiderohet i pakaluar për mjetet, nëse mesataret aritmetike të të paktën tre cikleve të fundit të përshpejtimit të lirë tejkalojnë vlerat e lejuara. Kjo mund të llogaritet duke injoruar çdo matje që devijon konsiderueshëm nga mesatarja e matur, ose me rezultatin e ndonjë kalkulimi tjetër statistikor që merr parasysh dispersionin e matjeve. Mund të kufizohet numri i cikleve të kontrollit. 5. Për të shmangur kontrolle të panevojshme mund të konsiderohet i pakaluar kontrolli për mjetet të cilat kanë vlera të matura të cilat tejkalojnë konsiderueshëm vlerat e lejuara pas							

	më pak se tre ciklesh përshpejtimi të lirë ose pas cikleve të pastrimit. Gjithashtu, për të shmangur kontrolle të panevojshme, mund të konsiderohet kontrolli i kaluar për mjete të cilat kanë vlera të matura që janë ndjeshëm nën kufijtë e lejuar pas më pak se tre ciklesh përshpejtimi të lirë ose pas cikleve të pastrimit.							
8.3 Reduktimi i interferencave elektromanjetike								
Radio interferenca (X) [2]								
8.4 Elemente të tjera të lidhura me mjedisin								
8.4.1 Rrjedhje lëngu								
9. TESTIME SUPLEMENTARE PËR MJETET E KATEGORIVE M2, M3 QË TRANSPORTOJNË UDHËTARË								
9.1 Dyert								
9.1.1 Dyert hyrëse dhe dalëse	Inspektim vizual dhe gjatë funksionimit							
9.1.2 Daljet e emergjencës	Inspektim vizual dhe gjatë funksionimit (aty ku është e mundur)							
9.2. Sistemi kundër avullimit dhe sistemi kundër ngrirjes(X) [2]	Inspektim vizual dhe gjatë funksionimit							
9.3 Sistemi i ventilimit dhe sistemi i ngrohjes (X) [2]	Inspektim vizual dhe gjatë funksionimit							
9.4 Ndenjëset								
9.4.1 Ndenjëset e udhëtarëve (përfshirë ndenjëset për personelin shoqërues)	Inspektim vizual							
9.4.2 Ndenjësja e shoferit (kërkesat shtesë)	Inspektim vizual							
9.5 Dritat e brendshme dhe udhëzimet për udhëtarët (X)[2]	Inspektim vizual dhe gjatë funksionimit.							
9.6 Korridoret, hapësira për qëndrim në këmbë të udhëtarëve	Inspektim vizual							
9.7 Shkallët dhe platformat	Inspektim vizual dhe gjatë funksionimit. (ku është e mundur)							
9.8 Sistemi i komunikimit me udhëtarët (X)[2]	Inspektim vizual dhe gjatë funksionimit.							

9.9 Mbishkrimet (X)[2]	Inspektim vizual						
9.10 Kërkesa lidhur me transportimin e fëmijëve (X)[2]							
9.10.1 Dyert	Inspektim vizual						
9.10.2 Pajisjet sinjalizuese dhe të posaçme	Inspektim vizual						
9.11 Kërkesa lidhur me transportimin e personave me lëvizshmëri të kufizuar (X)[2]							
9.11.1 Dyert, rampat dhe ashensorët	Inspektim vizual dhe gjatë funksionimit						
9.11.2 Sistemi për fiksimin e karrocave me rrota	Inspektim vizual dhe gjatë funksionimit (nëse është e mundur)						
9.11.3 Pajisjet sinjalizuese dhe të posaçme	Inspektim vizual						
9.12 Pajisje të tjera të posaçme (X)[2]							
9.12.1 Pajisjet për përgatitje të ushqimit	Inspektim vizual						
9.12.2 Pajisja sanitare	Inspektim vizual						
9.12.3 Pajisje të tjera (p.sh. sistemet audiovizuale)	Inspektim vizual						

[1] Homologimi në përputhje me direktivën 70/220/KEE, rregulloren (KE) nr. 715/2007, aneksin I, tabelën 1 (euro 5), direktivën 88/77/KEE dhe direktivën 2005/55/KE.

[2] Homologimi në përputhje me rregulloren (KE) nr. 715/2007, aneksin I, tabelën 2 (euro 6) dhe rregulloren (KE) nr. 595/2009 (euro VI).

[3] Homologimi në përputhje me direktivën 70/220/KEE, aneksin I, tabelën 1 (euro 5) të rregullores (KE) nr. 715/2007, direktivën 88/77/KEE dhe direktivën 2005/55/KE.

[4] Homologimi në përputhje me aneksin I, tabelën 2 (euro 6) të rregullores (KE) nr. 715/2007 dhe rregullores (KE) nr. 595/2009 (euro VI).

Shënime.

[1] "Kërkesat" janë të përcaktuara në certifikatën e homologim në datën e homologimit, regjistrimit të parë ose vënies së parë në shërbim, si dhe me plotësimin e detyrimeve lidhur me modifikimet ose me legjislacionin kombëtar në vendin e regjistrimit. Këto arsye për dështim janë të zbatueshme vetëm kur përputhshmëria me kërkesat është verifikuar.

[2] (X) Identifikon elementet që kanë të bëjnë me gjendjen e mjetit dhe përshtatshmërisë së tij për përdorim në rrugë, por që nuk konsiderohen thelbësore në një test të aftësisë teknike të mjetit.